

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës -Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike per shkollat dhe kopshtet”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
31224100-3; 44300000-3; 39715300-0

VLERA E FONDIT LIMIT: 4,082,378 (kater milion e tetedhjetë e dy mijë e treqind e shtatedhjetë e tete) lekë pa TVSH.

Kohezgjatja: 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga nënshkrimi i kontratës.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” *(i ndryshuar)*, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” *(i ndryshuar)*, autoriteti/enti kontraktor **Ndermarrja e Sherbimeve Publike**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Sigurimin e ofertës, sipas shtojcës 4;
- b. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DT;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” *(i ndryshuar)*.

1.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:

1.1.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kriterëve të pergjithshme të pranimit/kualifikimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP*(i ndryshuar)*, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*(i ndryshuar)*.

2.2Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy

balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, ndërsa kushti që bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar është vendosur në zbatim të nenit 41, të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” *(i ndryshuar)*. Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) duhet të jete në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vullë elektronike. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Udhëzimin nr.7, datë 10.01.2017 “Për disa shtesa në Udhëzimin nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” *(të ndryshuar)*. Në përcaktimin e këtij kriteri është mbajtur në vëmendje neni 61, pikat 2 dhe 5, i Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” *(i ndryshuar)*, ku citohet: “2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

5. Mënyra e deklarimit, përfshirë deklarimin elektronik, dhe formularët përkatës të deklarimit, paraqiten sipas përcaktimeve në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji. Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”.....

Përcaktimi i vlerës së kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2026 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, *(i ndryshuar)*, duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë

autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në Ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” (*i ndryshuar*), neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (*i ndryshuar*). Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2026 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” (*i ndryshuar*). Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori/et Ekonomik Ofertues duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë përvoja të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (*i ndryshuar*) dhe neneve 40, 55 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (*i ndryshuar*). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet/furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është bazuar në nenin 55 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.2 Operatori/ët Ekonomik duhet të paraqes/in deklaratë që furnizimi i mallrave do realizohet me angazhimet, mjetet dhe shpenzimet e operatorit ekonomik fitues brenda afatit dhe në ambientin

dhe/ose vendndodhjen e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP(i ndryshuar), nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"(i ndryshuar). Autoriteti Kontraktor, referuar objektit të procedurës që do të zhvillojë, në vijim të nenit 40, pika 5 e VKM-se 285 date 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), mund të kërkojë fuqinë punetore, mjetet dhe/ose pajisjet teknike që operatori ekonomik mund të vendosë në dispozicion për të përmbushur kontratën. Në këtë rast Autoriteti Kontraktor, Ndermarrja e Sherbimeve Publike, kërkon që operatori ekonomik, pa përcaktuar si kriter një numër minimal punonjësish dhe/ose mjet/esh të posaçme, të kryejë procesin e shpërndarjes dhe/ose furnizimit me mall me angazhimin e vetë operatorit ekonomik, në ambientin dhe/ose vendndodhjen që e Autoritetit Kontraktor.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ISO si më poshtë:

- a) Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001 :2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë certifikata ISO e kërkuar është e detyrueshme për secilin operator ekonomik, sipas zërave të preventivit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kërkesën që operatorët ekonomikë të paraqesin certifikata të sistemeve të menaxhimit të cilësisë, me qëllim garantimin e kapaciteteve të tyre për realizimin e objektit të procedurës sipas standardeve të kërkuara të cilësisë.

Kërkesa që certifikata të jetë e lëshuar nga organe të vlerësimit të konformitetit të akredituara nga organizmat kombëtarë të akreditimit ose organizma ndërkombëtarë të njohur nga Republika e Shqipërisë, është përcaktuar me qëllim garantimin e vlefshmërisë, besueshmërisë dhe paanshmërisë së dokumenteve të paraqitura nga operatorët ekonomikë.

Për rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, kërkesa që secili anëtar të paraqesë certifikatën përkatëse është vendosur me qëllim që çdo subjekt që merr përsipër realizimin e një pjese të kontratës të provojë se disponon sistemet e nevojshme të menaxhimit për fushën konkrete të angazhimit të tij.

Ky kriter nuk synon kufizimin e konkurrencës, por garantimin që operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedurë disponojnë kapacitete të organizuara dhe të dokumentuara për menaxhimin e cilësisë, në përputhje me kompleksitetin dhe rëndësinë e objektit të prokurimit.

2.3.4 Të gjitha mallrat objekt prokurimi duhet të jenë të reja, të papërdorura, të padëmtuara, në gjendje të plotë funksionale dhe në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. Mallrat e përdorura, të rikondicionuara ose të riparuar nuk do të pranohen. Mallrat duhet të dorëzohen në ambalazhin origjinal të prodhuesit, kur kjo është e aplikueshme.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm, i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve të teknike në përputhje me nenin 36, të ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/a dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në rast se gjatë hartimit të dokumentave të tenderit dhe kërkesave për kualifikim është përmendur ndonjë markë, operatorët ekonomikë ofertues kanë të drejtë të ofertojnë me ekuivalenten e tyre gjatë hartimit të ofertës ekonomike apo dokumentacionit të nevojshëm për të marrë pjesë në këtë procedurë.

VLERA E FONDIT LIMIT

Vlera e fondit limit të kontratës nga grupi i punës i ngarkuar për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, në mbështetje dhe zbatim të pikës 1, shkronja b) të nenit 76, të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar ku parashikohet se: b)Studimi i tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe

NJËSIA E PROKURIMIT